



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**EmriGjykates**

Numri i lëndës: 2021:285573

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05465199

Ac.nr.3112/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Ylber Shurdhiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “K.R” Sh.A me numër të biznesit ....., me seli në Prishtinë”, të cilin e përfaqëson L.XH nga Ferizaj, kundër debitorit R.T.K– RTK me NRB ....., me seli në rrugën XH.P, nr.12, Prishtinë, me objekt të përmbartimit kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.702/20, të datës 24.12.2021, me datë 18.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike përmbartimore dhe lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë–Dhomave të Shkallës së Dytë, si gjykatë kompetente në pikëpamje lëndore.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr.702/20, të datës 24.12.2021, e ka refuzuar të pabazuar prapësimin e debitorit R.T.K RTK me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.370/2020 i datës 17.06.2020, të lejuar nga përmbartuesi privat B.A.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë debitori, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit, të anulohet aktvendimi PPP.nr.702/20 i datës 24.12.2021 dhe urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.370/20 i datës 17.06.2020 të lejuar nga përmbartuesi privat.

Kreditori nuk na parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të tjera të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 29, 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se, në nenin 13 par.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, është përcaktuar: “ Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: pika 1.1 “kontestet ndërmjet

*shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”, ndërsa paragrafi 6 i nenit 13 i të njëjtit ligj përcakton: “Dhomat e shkallës së dytë janë kompetente për të trajtuar: pika 6.1, “ të gjitha ankesat ndaj vendimeve të dhomave të shkallës së parë brenda kompetencave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni”, andaj referuar këtyre dispozitave ligjore dhe duke qenë se palët ndërgjyqëse në këtë procedurë janë persona juridik, për vendosje në këtë çështje juridike përmbarimore, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Komerçiale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë.*

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në bazë të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 29 dhe 208 të LPK-së, e lidhur me nenin 13 par.1 pika 1.1 dhe par.6 pika 6.1 të Ligjit për Gjykatën Komerçiale nr.08/L-015.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.3112/22, datë 18.03.2024

G j y q t a r i,  
Ylber Shurdhiqi